

VENDIM
Nr. 830, datë 21.10.2020

PËR RISHPËRNDARJEN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ORGANIKË DHE TË FONDEVE BUXHETORE NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE, PËR VITIN 2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12 e 17, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, dhe të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të sistemit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për vitin 2020, reduktohet me 8 (tetë) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të sistemit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në 5 978 (pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) punonjës.

2. Numri i punonjësve të sistemit të Ministrisë së Brendshme, për vitin 2020, shtohet me 8 (tetë) punonjës për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, duke e çuar numrin e përgjithshëm të sistemit të Ministrisë së Brendshme në 15 079 (pesëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e nëntë) punonjës.

3. Në programin “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”, për Ministrinë e Brendshme, shtohet fondi prej 3 073 000 (tre milionë e shtatëdhjetë e tre mijë) lekësh në zërin “Shpenzime korrente”, për vitin 2020, për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

4. Në programin 01160, “Lufta kundër transaksioneve financiare joligjore”, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, reduktohet fondi prej 3 073 000 (tre milionë e shtatëdhjetë e tre mijë) lekësh, në zërin “Shpenzime korrente”, për vitin 2020.

5. Numri i përgjithshëm i punonjësve organikë buxhetorë nuk ndryshon.

6. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare jo më vonë se 30 ditë nga data e hyrjes në fuqi.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe